

VENDIM I ORTAKËVE
TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BLUE TDI SH.P.K.

BLUE TDI Sh.p.k., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar rregullisht sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (“**QKB**”), me NUIS L91926023K dhe me seli në adresën: Rruga “Themistokli Gërmenji”, Ndërtesa 1, Tiranë, (këtu e më poshtë referuar si “**Shoqëria**”).

Vendi i Mbledhjes: Tiranë, Shqipëri

Data e Mbledhjes: 07.12.2022

Nr i vendimit: 1

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë përbëhet nga Ortakët e Shoqërisë, si më poshtë:

- Ortaku, Shoqëria **Matrix Konstruksion Sh.p.k.** zotërues i 32.50 % (tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitalit. Shoqëria perfaqesohet ne mbledhje nga Znj.Ida MEZINI
- Ortaku, Shoqëria **GBI Sh.p.k.** zotërues i 22.50% (njëzet e dy pikë pesëdhjetë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitalit. Ne kete mbledhje perfaqesohet nga Z. Hajredin DIBRA
- Ortaku, Shoqëria **WSI Sh.p.k.** zotërues i 45% (dyzet e pesë përqind) të kapitalit që i korespondon 1 (një) pjesë e kapitalit. Ne kete mbledhje perfaqesohet nga Z.Bledar SINANI

Rendi i ditës:

- Vendim mbi fillimin e procedurës për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- Caktimi i Audituesit Ligjor për përgatitjen e raportit mbi zmadhimin e kapitalit të regjistruar.
- Të Ndryshme.

MEQËNËSE:

A. BLUE TDI Sh.p.k., është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me kapital të zotëruar nga ortakët e shoqërisë.



- B.** Në përputhje me Nenin 6, paragrafi (6.1), të Statutit të Shoqërisë, Ortaket e Shoqërisë dëshirojnë të fillojë procedurat për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, nga vlera aktuale prej 251,210,298 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë në **275,807,856 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milion e tetëqind e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.**
- C.** Në përputhje me Nenin 9, paragrafi (9.2), pika b, të Statutit të Shoqërisë, Ortaket e Shoqërisë dëshirojnë të caktojë shoqërinë I.L.D.-99 Audit sh.p.k me nipt K31516110I me seli në adresën Rr. Emin Duraku, Pall. Aviacioni i Vjetër, Shk. 6, Ap. 66, Tiranë, Shqipëri, të përfaqësuar nga administratori Z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelenë, Shqipëri, banues në Rr. “Komuna e Parisit”, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i licensës së Audituesit Ligjor Nr. 40, datë 10.02.2000, në cilësinë e Audituesit Ligjor me detyrën përgatitjen e raportit për zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- D.** Janë plotësuar të gjitha kushtet për mbajtjen e Mbledhjes së Asamblesë, e cila është thirrur dhe organizohet në përputhje me Statutin dhe Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar (“**Ligji Tregtar**”).
- Pas diskutimit të çështjeve Asambleja e Ortakëve miraton me unanimitet të plotë vendimet e mëposhtme:

PËR SA MË SIPËR, Ortakët e Shoqërisë, VENDOSËN:

- I.** Të fillojnë procedurat për zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- II.** Të caktojnë shoqërinë I.L.D.-99 Audit sh.p.k me nipt K31516110I me seli në adresën Rr. Emin Duraku, Pall. Aviacioni i Vjetër, Shk. 6, Ap. 66, Tiranë, Shqipëri, të përfaqësuar nga adminisitratori Z. Luan Kamberi, lindur më 23.02.1965, në Tepelenë, Shqipëri, banues ne Rr. “Komuna e Parisit”, Tiranë, Shqipëri, mbajtes i licensës së audituesit ligjor me Nr. 40, datë 10.02.2000, në cilësinë e audituesit ligjor për përgatitjen e raportit lidhur me zmadhimin e kapitalit të Shoqërisë.
- III.** Të miratojnë në parim zmadhimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë nga vlera aktuale prej 251,210,298 (dyqind e pesëdhjetë e një milion e dyqind e dhjetë mijë e dyqind e



nëntëdhjetë e tetë) lekë në **275,807,856 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë milion e tetëqind e shtatë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.**

- IV. Të autorizojnë** Administratorin e Shoqërisë, Zj. Ana Lleshi në lidhje me nënshkrimin dhe dorëzimin për llogari të Shoqërisë të çdo dokumenti të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi dhe në përgjithësi të kryejë të gjithë veprimet e duhura për kompletimin e tij dhe të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për depozitimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri në marrjen e ekstraktit përkatës që vërteton kryerjen e këtyre veprimeve për të cilat autorizohet.

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, përbërë nga Ortakët e Shoqërisë, që u mbajt sot më 07.12.2022 dhe që u mbyll në orën ____:00, nuk u mor asnjë vendim tjetër.


ORTAKËT E SHOQËRISË

WSI Sh.p.k.



Bledar SINANI




Matrix Konstruksion Sh.p.k.


Ida MEZINI




Hajredin DIBRA
